

URDHËR
Nr. 438, datë 10.9.2019

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR
JOPUBLIK TË NIVELIT TË ARSIMIT TË MESËM, SHKOLLA E GJUHËVE
TË HUAJA “EUROLINGUA”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3 dhe 7 të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të udhëzimit nr. 15, datë 12.07.2013 “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor jopublik të nivelit të arsimit të mesëm, shkolla e gjuhëve të huaja “Eurolingua”, Tiranë, licencuar me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin nr. 192, datë 31.7.2003 “Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor jopublik parauniversitar ‘Eurolingua’”.

2. Institucioni arsimor jopublik i nivelit të arsimit të mesëm, shkolla e gjuhëve të huaja “Eurolingua” ka këto detyrime:

a) të pajisë çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar;

b) të vërë në dispozicion të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër;

c) të kthejë pagesat e kryera nga nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbytur që mund të ketë ndaj nxënësit;

d) të dorëzojë në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer;

e) të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij urdhri, të mbulohen nga institucioni përkatës i arsimit parauniversitar privat.

3. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit ndodhet shkolla, ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor jopublik të nivelit të arsimit të mesëm, shkolla e gjuhëve të huaja “Eurolingua”;

b) të marrë masat për transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të gjithë nxënësit e regjistruar në këtë institucion arsimor;

c) të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar privat;

d) të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit për arkivat, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor jopublik i nivelit të arsimit të mesëm, shkolla e gjuhëve të huaja “Eurolingua”.

4. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar të marrë të gjitha masat sipas parashikimeve të Kodit Civil, ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi për personin juridik që përfaqëson institucionin e përcaktuar në pikën 1, i cili nuk zbaton këtë urdhër.

5. Urdhri nr. 192, datë 31.7.2003, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor jopublik parauniversitar ‘Eurolingua’”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në MASR,

institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe institucioni arsimor jopublik i nivelit të arsimit të mesëm, shkolla e gjuhëve të huaja “Eurolingua”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini